



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.46/2026

**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtarët: Ramush Bardiqi - kryesues, Hidajete Gashi Alaj dhe Kujtim Pasuli - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e [REDAKTUAR] nga Komuna Kaçanik, e paraqitur kundër Këshillit të Vendvotimit - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive në ditën e votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më datë 07 Qershor 2026, në seancën e panelit të mbajtur me 12.06.2026, merr këtë:

#### V E N D I M

**REFUZOHET E PABAZUAR** ankesa ZP.Anr.46/2026 e datës 10.06.2026, e parashtruar nga [REDAKTUAR] nga Komuna Kaçanik, kundër Këshillit të Vendvotimit - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive në ditën e votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më datë 07 Qershor 2026.

#### A r s y e t i m

Me datën 10.06.2026, PZAP-i përmes postës ka pranuar ankesën ZP.Anr.46/2026, e dërguar në postë me datë 08.06.2026, nga [REDAKTUAR] kundër kryesuesit të Këshillit të Vendvotimit - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), Albin Bunjaku, me të cilën pretendon se në ditën e votimit me datë 07.06.2026, gjatë procesit zgjedhor, rreth orës 16:00 ka vërejtur një parregullsi. I njëjti ka vërejtur se si një votues me emrin [REDAKTUAR] ka hyrë të asistoj me gruan e axhës, e quajtur [REDAKTUAR] pa dokumente të mjekut, sepse gruaja në fjalë ka qenë e aftë të votoj vetëm dhe pa asistencë. Dëshmitarë janë ankuesi dhe gruaja e tij. Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë dëshmi lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigjen në ankesë me datë 10.06.2026 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), ka deklaruar se pas shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve të palës ankuese jep sqarimet/përgjigjet si më poshtë: Bazuar në nenin 6 të Rregullores Zgjedhore Nr. 12/2024 për Votimin, Numërimin në Vendvotim dhe Menaxhimin e Vendvotimit përcaktohet në mënyrë të detajuar mbarëvajtja, ecuria dhe obligimet në vendvotim. KQZ, pas pranimit të kërkesës së PZAP, menjëherë ka kontaktuar me KKZ e komunës së Kaçanikut, duke pranuar përgjigjet dhe sqarimet si në vijim: *"Komisioni Komunal i Zgjedhjeve në Kaçanik në kuadër të ditës së zgjedhjeve ka bërë monitorimin e procesit zgjedhor në tërësi, duke qenë aktiv me ekipet e monitorimit gjatë gjithë kohës nëpër qendra të votimit, përkatësisht nëpër seciljn vendvotim.*

*Nga qendra e votimit 0707 përkatësisht vendvotimi 0707/02 fshati Biqec, ku kryesues ka qenë Albin Bunjaku, ne nuk kemi marrë asnjë ankesë apo kërkesë nga asnjë palë. Gjithashtu ekipet e KKZ-së në Kaçanik nuk kanë evidentuar ndonjë parregullsi gjatë monitorimit në këtë qendër.” Të bashkangjitur keni deklaratën e KKZ-së në Kaçanik.*

Gjithashtu, ju njoftojmë se lidhur me rastin në fjalë, nuk është raportuar për ndonjë parregullsi në dhomën operative të KQZ-së në ditën e zgjedhjeve, më datë 07.06.2026. Në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP, gjatë shqyrtimit të ankesës është vërejtur se pala ankuese, nuk ka bashkëngjitur prova relevante, siç janë; Numri i Qendrës së votimit, numri i vendvotimit ku ai supozon se ka pasur parregullsi, libri i votimit apo ndonjë material tjetër zgjedhor që do të dëshmonin apo mbështesnin pretendimet tij lidhur me votimin me asistencë.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, gjeti se:

**- Ankesa është e pabazuar.**

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga KQZ-ja, vlerësoj se pretendimet e parashtruesit të ankesës, [REDAKTUAR] janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nuk është arritur që të vërtetohen se ka pasur parregullsi në qendrën e votimit Biqec, komuna e Kaçanikut dhe se ka pasur parregullsi në qendrën e vendvotimit. Kjo për faktin se parashtruesi i ankesës lidhur pretendimet e tij nuk i ka mbështetur me prova, rrjedhimisht nuk ka ofruar asnjë dëshmi të qartë dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara, edhe pse në bazë të dispozitave ligjore në fuqi, barra e të provuarit bie mbi ankuesin dhe në rastin konkret, paneli me asnjë provë nuk ka mundur të konstatoj se ka pasur parregullsi në ditën e votimit në qendrën e votimit të komunës së Kaçanikut.

Paneli vlerëson se nga përgjigja e KQZ-së cila ka bashkangjitur si prove edhe përgjigjen-deklaratën e KKZ Kaçanik, ne te cilën është sqaruar se, "Komisioni Komunal i Zgjedhjeve në Kaçanik në kuadër të ditës së zgjedhjeve ka bërë monitorimin e procesit zgjedhor në tërësi, duke qenë aktiv me ekipet e monitorimit gjatë gjithë kohës nëpër qendra të votimit, përkatësisht nëpër secilin vendvotim. Nga qendra e votimit 0707 përkatësisht vendvotimi 0707/02 fshati Biqec, ku kryesues ka qenë Albin Bunjaku, ne nuk kemi marrë asnjë ankesë apo kërkesë nga asnjë palë. Gjithashtu ekipet e KKZ-së në Kaçanik nuk kanë evidentuar ndonjë parregullsi gjatë monitorimit në këtë qendër në ditën e zgjedhjeve, më datë 07.06.2026. Është vlerësim i Panelit se këtu ankuesi si dëshmitarë në vendvotimin e caktuar në momentin kur ka vërejtur parregullsinë është dashur që të njoftojë kryesuesin e KVV lidhur me parregullsinë konkrete, e të cilën në rastin konkret nuk e ka bërë, andaj dhe nuk ka mundur të vërtetohet se ka ndodhur shkelja e pretenduar.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: "*Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*", Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkuara në ankesa nuk ka bashkëngjitur asnjë prove, përkatësisht prova me te cilën do të identifikohet Numri i Qendrës së votimit, numri i vendvotimit ku ai supozon se ka pasur parregullsi, libri i votimit apo ndonjë material tjetër zgjedhor që do të dëshmonin apo mbështesnin pretendimet e theksuara si më lartë, andaj në mungesë të provave lidhur me shkeljet e pretenduara ankesa si e tillë u deshtë të refuzohet e pa bazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 par. 3, neni 118 par.1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

ZP.Anr.46/2026 më datën 12.06.2026



**Kryesues i Panelit**  
**Ramush Bardhi**

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.